

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.27.02.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdyrrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Enver Gashi (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi, (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Vlora Mjekiqi Kabashi (LDK), Goran Dancetovic (SL), Biljana Spasic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës, Halil Thaçi, Berat Gashi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, UD e Njësitit Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi Sami Ahmeti, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të DIL-sënr.17-104-02-4418-26 e dt.12.02.2026 për bartjen e mjeteve për ndërtimin e QKMF-së, në Obiliq.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësimin dryshimit të vendimit me nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025 për themelimin e mekanizimit lokal koordinues për mbrojtjen nga dhuna, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesi – Unë fillimisht kam vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar te pika 6 e rendit të ditës, plotësimi i Komitetit për komunitete në faqen nr.5 ku shkruan anëtarët e Kuvendi për propozimin e parë votuan me 9 vota për dhe 9 vota kundër duhet të evidentohet në procesverbal se anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e parë votuan me 12 vota për dhe 9 vota kundër. Kjo, pasi që gjatë rishikimit të videos të seancës së fundit me kërkesën e anëtarit të Kuvendit z.Enver Gashi, është konstatuar se është bërë një lëshim gjegjesisht gabim nga ana ime në numrimin apo konstatimin e votave te kjo pikë e rendit të ditës.

Enver Gashi – Dua të lidhem me vërejtjen që e theksove. Nuk e di tash sa është me qëllim apo pa qëllim. Keni qenë të dytë kryesues, edhe Kryetari po në atë vend ku jeni edhe sot këtu. dhe 12 vota kanë qenë rend qysh jemi edhe sot këtu dhe është e palogjikshme prej 12 me i humbë 3 gjegjesisht me i vjedhë 3 vota. Nuk është turp shumë me vjedhë, por me u zënë faqja e zezë.

Fitore Hashani – Kryesues, në radhë të parë po e paraqes njoftimin e grupit të LDK-së dega në Obiliq, dhe sa i përket këtij njoftimi ju e keni marrë edhe shkresën në mënyrë elektronike ,se që nga kjo seancë grupin asambleistë të LDK-së, do ta përfaqësoj unë Fitore Hashani. Kërkoj bashkëpunim njëherit edhe respektim të shefit të grupit të LDK-së. Ndërsa sa i përket procesverbalit përveç vërejtjeve që ju dhe z.Gashi i theksuat, kemi edhe vërejtjet tjera sa i përket gjithë debateve ose konfrontimeve të ndryshme si në grupe vetë asambleistëve, ashtu edhe të debateve që janë zhvillue në Asamble. Bazuar në gjithë këto vërejtje dhe gabime, madje ka edhe gabime teknike dhe drejtëshkrimore që në disa raste mund të kushtojnë në të ardhmen, grupi jonë do të jetë kundër këtij procesverballi.

Kryesuesi – Kur flasim për vërejtjet, është mirë me thënë se cilat janë vërejtjet në mënyrë që të përmirësohen. Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 13 vota për dhe 7 vota kundër ,me vërejtjet e cekura më lart.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e propozimit të DIL-së nr.17-104-02-4418-26 të dt.12.02.2026 për bartjen e mjeteve nga projektet e planifikuara kapitale në projektin e ndërtimit të QKMF-së, në Obiliq. Fillimisht e ftoi drejtorin të na jepë informacione lidhur me këtë propozim.

Naim Shalaku – Ky projekt ka filluar para disa vitesh si renovim, por fatkeqësisht ka mbetë i papërfunduar dhe sot përballemi me një objekt në gjendje jo të mire, që vështirëson punën e stafit shëndetësor si dhe rëndon përditshmërinë e qytetarëve tanë. Dua të theksoj një fakt se në QKMF ofrohen 247,346 shërbime në vit dhe ky numër është tregues i ngarkesës, nevojës dhe varësisë së qytetarëve të Obiliqit që kanë nga ky institucion. Në bazë të analizave të përbashkëta që i kemi bërë me Kryetarin e Komunës dhe drejtoreshën e shëndetësisë kemi arritë në përfundim se zgjidhja më racionale e strategjike nuk është ndërhyrja e pjesëritshme, por është ndërtimi i një QKMF-je të re që i përgjegjet standardeve dhe nevojave reale të qytetarëve tanë. Shëndetësia primare është detyrimi institucional, është përgjegjësi ndaj çdo familje që pret shërbim me dinjitet në Komunën tonë. Prandaj, sot kërkoj nga ju që ta mbështetni bartjen e mjeteve kapitale në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme.

Fjolla Nasufi – Sa i përket bartjes së mjeteve për QKMF-në dua të theksoj se ky projekt nuk është improvizim, por është jetësor për banorët e Obiliqit, kështu që ne si grup i LVV-së e mbështesim propozimin e drejtorit dhe sqarimet e dhëna.

Fitore Hashani – Besoj se procedurat ligjore i dini edhe ju edhe Kryetari sa i përket shkresave që sille në Kuvend, siç e potencoi më lart z.Enver Gashi, ju keni përvojë në Kuvend kështu që nuk po mendoj që u bë ky lëshim aq drastik. Sa i përket shkresës në fjalë një drejtor i infrastrukturës është kompetentë të ekzekutoj buxhetin të cilin e obligon Kryetari i Komunës. Në këtë shkresë nuk e kemi as edhe një pikë të vetme se ku janë thirrë, çka është baza ligjore e shkresës, a është e miratuar dhe trajtuar në mbledhjet e Bordit dhe Ekzekutivit. Shkresa e tillë pasi që diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Bordit bashkë me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e financave vjen me një shtjellim të saktë dhe të qartë për të gjithë ne. Ju lutem, ju veç se i keni parë rekomandimet e KPF-së, se çfarë po ndodhë me këto shkresa, me vendime të cilat po rikthehen për shkak të procedurave jo të rregullta ligjore. Unë kisha kërkuar sqarim sidomos prej Kryetarit si do të realizohe: çka kuptojmë së pari dhe çka jo ,si Ekzekutiv me bartjen e mjeteve, cilin ligj e keni përdorë dhe çfarë do të ndodhë me të gjitha projektet të cilat janë realizuar dhe janë dikund mbi 18 vija të projekteve kapitale në infrastrukturë derisa kjo Drejtori në total ka të përfshirë 33 projekte të infrastrukturës rrugore të tkurren dhe të drejtohen për neve dhe për buxhetin e saj në 4 projekte kapitale. Projektet kapitale të cilat drejtori ka kërkuar që ti ridestinoj ,mjetet në ndërtimin e një projekti të ri, që nuk është as afati ligjor i tij të vendoset si kod buxhetor, janë projektet të cilat janë realizue në debatet publike me qytetarët për më shumë se 40 debate publike të cilat janë edhe në faqen zyrtare të Komunës dhe ju mund ti gjeni lirisht ato. Të gjitha këto përzgjedhje të projekteve janë realizuar duke i votuar vetë qytetarët. Unë dua ti lexoj secilën nga ato, sepse janë me rëndësi dhe duhet të dijnë qytetarët se çfarë do të ndodhë në të ardhmen me këto projekte. Projektet të cilat kërkohen nga drejtori i infrastrukturës të largohen nga buxheti, i cili tashëm është i miratuar qysh në shtator të vitit 2025, janë: asfaltimi i rrugës “Ismail Mjeku” vazhdimi i saj në fshatin Graboc, pishina dhe instalimi,të cilat nuk e keni prekur: asfaltimi i segmenteve të rrugës “Halit Bici”dhe parkingu në Mazgit të Epërm te lagjja e “Raqëve”, asfaltimi i rrugës Hamidi, Siboc, Lajthishtë, asfaltimi i rrugës ”Dëshmorët”

së bashku me segmentet e tij, asfaltimi i rrugës “Ajete Kelmendi” së bashku me segmente, asfaltimi i rrugës “Molla e Kuqe” së bashku me segmente dhe në Lajthishtë: asfaltimi i rrugës “Hoxhë Breznica” në fshatin Breznicë: ndërtimi i kanalizimit në komplet qytetin e Obiliqit: ndërtimi i kanalizimit dhe ndërtimit të trotuarit të rrugës “Dita e flamurit” në Mazgit të Lartë rregullimi i kanalizimit “Vëllezërit Bashkimi” dhe segmentet e tij në fshatin Plemetin, ndriçimi publik dhe vendosja e kamerave në lagjen “Hadja e Re” asfaltimi në rrugën “Çlirimi” me segmentet e saj: ndërtimi i katit të tretë në QKMF, blerja e instrumenteve muzikore kulturore: ndërtimi i trotuarit në rr.”Nuhi Kelmendi” ndërtimi i parkut te çerdhja në Mazgit, ndërtimi i parkut te lagjja “Haziri” në Mazgit. Të gjitha këto projekte janë projekte të cilat janë debatue nëpër debatet publike që i obligon Ligji i Financave publike të definohen dhe të iu jepen me prioritet për të gjithë qytetarët tanë. Përveç kësaj, unë dua prapë sqarim prej Drejtorisë së Financave kur bëhet bartja e mjeteve, sepse ,siç e kuptojmë, me bartjen e mjeteve, kjo pikë kërkon shumë debat ,sepse as edhe një rregullë nga Ligji i Financave nuk është respektuar.

Labinot Mirena – Unë e kam një pyetje për drejtorin e infrastrukturës: a janë pjesë të projektit që merren për me shkue në QKMF.

Naim Shalaku – Po.

Labinot Mirena – Mendoj se është hap i jashtëzakonshëm dhe shumë i mirë. Unë fëmijët i kontrolloj në atë ambullantë dhe i falenderoj prej drejtorit të QKMF-së, e deri te punëtori më i thjeshtë që është në ambullantë sepse në çfarë kushte kanë punuar ata deri në këtë kohë është turp ne me bllokue këtë proces të investimeve në QKMF. Unë jam i kënaqur dhe dhëntë zoti të kryhet sa më shpejtë ai ndërtim sepse është hap shumë i mirë në këtë drejtim.

Bajram Hashani – Askush nuk është kundër ndërtimit të ambullantës së re dhe të jeni të bindur se edhe ne jemi për atë punë që të kryhet ajo ose të ndërtohet. Krejtë është në rregullë veç duhet ashtu qysh e tha znj.Fitore, a keni bazë ligjore, ku po bazoheni vetëm arsyetone këtë dhe jemi në rregullë. Mirëpo, është edhe tjetra me i marrë mjetet prej këtyre projekteve, a nuk po keni mundësi me i marrë dikund tjetër, apo me marrë ndonjë donacion prej Qeverisë.

Kryetari – Mirë është bile të paktën për QKMF hiç mos me pasë debat. Ju e dini se çka keni bërë me QKMF-në, ja ku është kontrata me kend e keni bërë kontratën dhe e dini gjendjen qysh është. Ju e keni lënë pa kulm QKMF-në sot e 3 vite sa janë pa kulm në çfarë gjendje 22,800 banorë të Komunës së Obiliqit marrin shërbime aty. Të paktën, bile këtu kursene mos folni fare për këtë temë sepse është turp ,dhe duhet me ardhë një prokuror me u marrë me këtë çështje. E keni pranuar një donacion, e keni lënë me punue një operatorë aty pa pasë alokim të mjeteve. Këtu, të paktën bile kursena se e kemi për qytetarët tanë. Unë iu kërkoj falje të gjithë atyre qytetarëve që janë mashtruar me këto projekte që i përmendi asambleistja më heret, ama diçka më të rëndësishme se shëndeti nuk kemi. Më falni rruga pret edhe në vitin tjetër, ama shëndeti nuk pret. Pra, kemi me bë të pamundurën, kemi me fillue shumë shpejtë ndërtimin e një QKMF-je të re.

Fitore Hashani – Në asnjë fjali timen nuk isha kundër ndërtimit të QKMF-së, vetëm kërkova sqarime dhe procedura ligjore si do të realizohet. Meqenëse, unë nuk mora përgjegje as prej Kryetarit, as prej drejtorit paraprak, por as edhe prej Drejtorisë së Financave vetëm dua të sqaroj sa për opinionin dhe për qytetarë,se bartja e mjeteve, apo termi bartje e mjeteve nuk ka mundësi të bëhet në muajin shkurt. Bartja e mjeteve bëhet në fund të vitit . Të lutem Kryetar,s janë 3 terminologji, dhe nëse për ty nuk janë të rëndësishme me i sqaru, të dëgjova Kryetar nëse, ke durimin me dëgju, sepse është e drejta e fjalës time. Unë vetëm një gjë po kërkoj sqarim prej Drejtorisë aktuale kur nënkuptojmë të bëjmë bartje të mjeteve, kur nënkuptohet të bëhet rialokimi i mjeteve dhe kur bëhet transferi mjeteve. Është Ligji i Financave publike i cili i definojnë këto çështje. Nëse, ju na sjellni shkresa se kjo procedurë do të realizohet në rregullë me Ligjin e Financave publike, as edhe një asambleistë nuk është kundër ndërtimit të një objekti të ri ose mbështetjes, marrjes së donacioneve të ndryshme nga Qeveria. Uroj se do të kemi sqarime për këtë pikë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 12 vota për 6 vota kundër dhe 3 vota abstenim morën vendim për Ri-alokimin e mjeteve nga projektet e planifikuara kapitale në projektin e ndërtimit të QKMF-së, në Obiliq.

Pika 4 e rendit të ditës.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore për plotësim ndryshim të vendimit me nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025 për themelimin e mekanizmit lokal koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore. Duke pasë parasysh se është ndryshu struktura e Komunës, në këtë mekanizëm ndryshon vetëm emri i Kryetarit: z.Halil Thaqi meqë përpara ka qenë: z.Xhafer Gashi dhe ndryshon emri i drejtoreshës së shëndetësisë ndërsa, anëtarët tjerë mbeten të njëjtë.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 21 vota për, morën vendim për Plotësim ndryshimin e vendimit nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025 për Themelimin e mekanizmit Lokal Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në bazë Gjinore me këtë përbërje:

1. Halil Thaqi, Kryetar
2. Albertina Dedinca, DSHMS
3. Edita Çanta, Gjykata Themelore Prishtinë
4. Arlind Popaj, Prokuroria
5. Mema Mjeku, ZMNY – Prokuroria
6. Reijan Ibrahim, BIK-Obiliq
7. Mexhid Krasniqi, QPS
8. Adlije Seta, Policija e Kosovës
9. Zana Asllani, Strehimorja – QMGF
0. Fatime Pllana, DKA
11. Vjollca Hoti, QKMF
12. Slavisa Adjancic, ZLK
13. Faton Jashari, Ndihma Juridike Falas A.N.J.F.
14. Emine Berisha, Zyra e punësimit
15. Ganimete Aliu, Njësia antidiskriminim dhe barazi gjinore
16. Zelushe Kelmendi, Qendra Rinore

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete për arsye të përfaqësimit të barabartë gjinor, sipas Ligjit nr.05/L-020 për Barazi Gjinore kërkohet minimumi 50 % përfaqësim për secilën gjini në organet politike drejtuese përfshirë edhe ato vendimmarrëse. Ne sot duhet në përbërjen e Komitetit për Komunitete të shtojmë një anëtare të gjinisë femërore nga përbërja e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kështu që i mbetet LDK-së, të na japë 2 propozime ku njëri prej tyre duhet të jetë i gjinisë femërore.

Fitore Hashani – Shkresën që sapo e lexuat nga MAPL-ja, a ka mundësi ta kemi edhe ne si grup. Po ashtu kemi vërejtje sa i përket ligjshmërisë së vendimeve që po kthehen nga MAPL-ja, nuk kemi asnjë herë njoftim, por po e lemë në pikën: të ndryshme. Kryesues, ne iu kemi drejtuar edhe me shkrim nuk e di nëse e keni marrë letrën tonë, dhe është mirë herave tjera paraprakisht të njoftohemi me përgjigje nga MAPL-ja, në mënyrë që mos të vijmë pastaj në situata jovendimmarrëse. Sa i përket propozimit meqenëse është në pyetje kuota gjinore nga LDK-ja, propozoj znj.Lendita Bektoshi dhe z.Muhamet Preniqi.

Abdyrrahman Krasniqi – Nëse ligji e përcakton se duhet me qenë 50 % prapë nuk po e mbërrijmë 50 %-in, jemi 5 me 4 kështu që ta kemi parasysh këtë çështje.

Kryesuesi – Unë kam marrë përgjigje për këtë çështje se 5 me 4 bën.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës morën Vendim me 19 vota për dhe 2 vota kundër për formimin e Komitetit për Komunitete me këta anëtarë: Mervete Shala, Arbenita Pllana, Linda Bektoshi, Muhamet Preniqi, Goran Dancetovic, Sanela Mackic, Avdyl Mustafa, Faton Beka dhe Haki Abazi.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit për zgjedhjen e Nënkryetarit të Komunës për komunitete, z.Stevan Radosavljevic për arsye se vendimi nuk është votuar nga shumica e anëtarëve të Kuvendit që i përkasin komunitetit joshumicë. Atëherë, unë kërkoj nga Kryetari i Komunës të

na informoj se a ka ndonjë propozim apo dëshiron përsëri ta vendosim në rivotim zotëriun në fjalë.

Kryetari - Në veçanti kërkoj nga komuniteti serbë që ta votojnë kandidatin që unë do ta propozoj tani dhe sigurisht se ne mbetemi të përkushtuar që të bashkëpunojmë me komunitetin dhe të punojmë për përmirësimin e jetës së tyre. Kandidati që unë do ta propozoj është: z.Stevan Radosavljevic, i njëjti ai që ka qenë një muaj përpara dhe kërkoj të votohet ky kandidat.

Kryesuesi - Atëherë e hodhi në votim propozimin e Kryetarit për zgjedhjen e Kryetarit për komunitete z.Stevan Radosavljevic.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës votuan me 13 vota për dhe 7 vota abstenim për zgjedhjen e Nënkyetarit për komunitete.

Kryesuesi – Pasi që nuk i kemi votat e komunitetit ashtu siç është paraparë me ligj, mua më vjen keq që me votat e komunitetit nuk ka përfaqësim të serbëve dhe ne duhet që vendimin e muajit të kaluar për zgjedhjen e z.Stevan Radosavljevic ta shfuqizojmë sepse nuk është arritë numri i votave.

Anëtarët e Kuvendit Komunal votuan me 13 vota për dhe 7 vota abstenim morën Vendim për Shfuqizimin e Vendimit për zgjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL për rishqyrtimin e vendimit nr.01-060-01-2992-26 i dt.30.01.2026, Nic Home SH.P.K. nga Florim Kelmendi, për plotësim ndryshim të kontratës e cila është në emër të “Nic Home” SH.P.K. të kaloj në emër të “Nic Tech” LLC pronar i të dy bizneseve në Milloshevë. MAPL-ja, ka vlerësue se ky vendim ka të bëjë me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës komunale te një palë e tretë. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale nuk mund të bartet te personat e tretë dhe ndryshimi e administrimi i këtyre kontratave është kompetencë e Ekzekutivit, do të thotë e Kryetarit e jo e Kuvendit Komunal.

Fitore Hashani - Vetëm sa për rikujtim e kemi sqaru në seancën kur ju e keni lexue dhe propozue këtë vendim madje, e patëm falenderue Kryetarin dhe Ekzekutivin për transparencën dhe punën ndërsa, si procedurë e kemi sqarue se si duhet të vazhdojmë. Na vjen mirë që MAPL-ja, është në një vijë me neve sepse ligjet dhe procedurat në fuqi janë më aktuale.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 20 vota për dhe 1 votë kundër morën Vendim për Shfuqizimin e Vendimit nr.01-060-01-2992-26 i dt.30.01.2026 për aprovimin e kërkesës nga Florim Kelmendi “Nic Home” SH.P.K. për plotësim ndryshimin e kontratës me nr.II/420 të dt.14.05.2021 e cila është në emër të “Nic Home” SH.P.K. të kaloj në emër të “Nic Tech” LLC pronar i të dy bizneseve në Milloshevë.

Kryesuesi – E kemi plotësim ndryshimin e vendimit të aksionarëve KRM “Pastrimi”. Me kërkesën e anëtarit të Kuvendit të Komunës, gjegjësisht anëtarit të KPF-së, z.Labinot Mirena që të sqarohen burimet e mjeteve për pagesën e anëtarëve sipas praktikave të mëhershme ne duhet të nxjerrim një vendim.

Vendimin e këtij Komisioni të shtojmë në tekst, “Për punën e tij Komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal kompensohet me pagë mujore sipas legjislacionit në fuqi, dhe në përputhje me rregullat dhe aktet e kompanisë KRM “Pastrimi”.

Fitore Hashani – Pas kësaj pike menjëherë e kemi edhe pikën tjetër NPL “Kastrioti” dhe nëse është tema e njejtë për të dyjat sa i përket buxhetit, unë e di qartë po i përmendë 2 ligjet që ju veç i potencuat, është edhe një vendim shtesë në koordinim me zyrën kombëtare të auditimit që ka pasë ardhur si rrjedhojë e Kuvendit Komunal dhe vendimeve të asaj kohe sepse ne e dijmë se Kuvendi nuk jepë urdhëra, as nuk bën planifikime të buxhetit, aq më pak vendime ku duhet të ekzekutohet paga e ndonjë Komisioni. Prandaj, mendoj se kjo temë duhet të trajtohet me Drejtoritë gjegjëse konkretisht me Drejtorinë e Financave dhe Zyren e auditorit të brendshëm që të gjendet moduli i cili duhet të aplikohet në mënyrë që të mos kemi gjetje të auditorit të kësaj fushe.

Kryesuesi - Vendimet e njëjta që i ka marrë ky Kuvend, këto vetëm po rishikohen për shkak të ndërrimit të emrave të personave.

Labinot Mirena – Deshta vetëm një sqarim për shefin e grupit, do të thotë se është vetëm për mjetet për kompensim që të merren nga mjetet vetanake të kompanive. E ke kolegun tënd nga ana e djathtë kolegun tim z.Fidan që ishte aksionar, dhe kolegun prapa z.Abdyrrahman do të thotë është i njëjti vendim që duhet të plotësohet. Është vetëm kjo që atëherë kemi harruar me përfshi për pagën minimale të Ndërmarrjeve.

Fitore Hashani – Faleminderit z.Mirena për sqarim, por prapë e lamë ta diskutojmë në të ndryshme, mirëpo secila pikë po atakohet me gjërat e njëjta kështu që kryesues derisa nuk i kemi sqarimet në formë të shkruar se çfarë do të trajtojmë po arrijmë te pyetjet e parashtruara dhe as nuk e diskutuam se a ka mundësi, a jemi pro apo kundër pagesës së këtyre Komisioneve. Unë nuk mendoj se duhet të nxjerrim vendime duke u konsultuar me kolegët apo ish kolegët paraprak, por duke i sqaruar temat këtu në seancë për këtë arsye edhe vijmë në seancën e Kuvendit. E falënderoj z.Mirena për gatishmërinë dhe sqarimet ndoshta të njëjtën gjë do të duhet të na shkruani që nga përfundimi i mbledhjes së KPF-së që është mbajtur dje dhe ta kemi në të gjithë asambleistët këtë diskutim dhe këto vendime që ju po i merrni.

Kryesuesi – Përsëri ju informoj se në pikën të ndryshme do ta diskutojmë këtë temë.

Pas diskutimeve anëtarët e Kuvendit të Komunës me 12 vota për dhe 7 vota abstenim morën vendim që Komisioni Komunal i Aksionarëve të Kompanisë “Pastrimi” për punën e tij të kompensohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” në përputhje me Rregulloret dhe aktet e kompanisë publike.

Kryesuesi – E njëjta temë është për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të aksionarëve të NPL “Kastrioti” me të njëjtën përmbajtje që për punën e tij Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës kompensohet me pagë minimale sipas legjislacionit në fuqi.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 12 vota për 1 votë kundër dhe 8 abstenime morën vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit të emëruar nga Kuvendi i Komunës NPL “Kastrioti” që për punën e tij të kompensohet nga Kompania NPL “Kastrioti” në përputhje me Rregulloret dhe aktet e kompanisë publike.

Të ndryshme

Enver Gashi – Ne në legjislaturat tjera të Kuvendit, e kemi pasë një mbushje telefonike dhe tash nuk e di a jeni në ngjarje dhe grupi ynë ka kërkuar të na jepni një sqarim. E dyta, te pajisja me laptop e kam një vërejtje pikërisht nga z.Muhamet Preniqi, që laptopi nuk është Iphone, janë laptop të vjetër shumica që i kanë marrë, kështu që kanë vërejtje.

Kryesuesi – Sa i përket mbushjeve elektronike kam qenë i informuar nga legjislatura e kaluar që janë dhënë mbushjet dhe unë në atë kohë nuk i pata pranuar. Mirëpo, do të interesohem menjëherë, është e drejtë e anëtarëve të Kuvendit dhe shumë shpejtë do të iu japim përgjigje sepse kjo është diçka që duhet të bëhet. Sa u përket laptopëve, ju e dini se në legjislaturën e kaluar i kemi marrë laptopët të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal dhe unë e kam përdorë bukur shumë atë laptop ndoshta, më së shumti prej të tjerëve nuk kam pasë ndonjë vërejtje dhe nuk e kam dorëzuar. Tash kemi kërkuar nga anëtarët e legjislaturës së kaluar ti kthejnë laptopët, por 2 prej tyre ende nuk i kanë kthyer. Ata laptop që i kemi pasë ne kemi pasë dëshirë me ju ofruar, për faktin se ka materiale shumë, mos me ju ra me printu. Ne nuk kemi ndonjë vijë buxhetore për laptop të rinjë.

Fitore Hashani – Ne kemi marrë disa shkresa si shqetësim prej palëve, konkretisht prej qytetarëve të Komunës tonë lidhur me vendimin e Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-2609/26 të dt.27.01.2026. Ne si grup e patëm përgëzuar Kryetarin, për vendimin e marrë që ka të bëjë me përcaktimin e gjobave mandatore në mbrojtjen e mjedisit, por shqetësimi ynë lidhet me vendimin që fatmirësisht e gjetëm në Faqen Zyrtare të Komunës. Kryetar propozoi që vendimi të plotësohet për arsye se nuk ka preambulë dhe bazë ligjore se ku bazohen inspektorët me shqiptu gjoba. Po ashtu, në të ardhmen si Komunë mund të ndeshemi me gjoba ndaj Komunës të këtyre palëve, ose edhe qytetarëve që ne mund të ju shqiptojmë gjoba. Shqetësimi i dytë lidhet përsëri me vendimin e njëjtë se disa procesverbale të inspektorëve nëse, nuk gabojnë dhe nëse jam shumë e saktë i kam hasë te web faqja ose te rrjetet sociale të drejtorit të inspeksionit, ku janë të postuara disa procesverbale, dhe shqetësimi im lidhet me 3 nënshkruesit e procesverbalit ku 2 prej tyre janë zyrtarë të rinjë. Do të doja të di nëse janë inspektorë mjedisor sepse ju e dini se Ligji për mjedisin e specifikon se gjobën ka të drejtë ta shqiptoj vetëm zyrtari mjedisor dhe është Drejtoria e mjedisit. Unë sa kam njohuri nuk është i specializuar dhe i certifikuar sa i përket çështjes së mjedisit. Këto, çështje i ngriti në mënyrë që mos të ketë padi ose situata jo të lakmueshme zyrtarët e inspeksionit dhe ata të mjedisit nisur prej ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi. Prandaj propozoj që këto 2 vendime përveç që të plotësohen kërkoj edhe sqarime prej Departameve ligjore të 2 Ministrive gjegjëse, konkretisht edhe prej

Zyres ligjore të Komunës, që të paktën të bëjnë këto përmirësime dhe të mos kemi probleme në të ardhmen, qoftë zyrtare qoftë vetë Komuna sepse mund të vijmë deri te dëmtimet e mëdha buxhetore.

Kryesuesi – Për dy çështjet e ngritura ju do të merrni përgjigje në kohën e duhur.

Kryetari – Është pyetje që më është drejtuar mua rreth çështjes së gjobave. Unë ju bëj thirrje qytetarëve të na ndihmojnë ta mbajmë të pastër Komunën e Obiliqit, ndërsa sa i përket gjobave jemi të pakompromis qoftë edhe me u përballë me Gjykata, e sidomos edhe me ato biznese që po vijnë nga Prishtina e po i sjellin mbeturinat në Komunën e Obiliqit. Këtu, do të jemi të pakompromis dhe unë nuk e di nëse, dikujt i intereson me pasë deponi ilegale në Obiliq, nuk kisha pasë dëshirë të paktën në këtë sallë me pasë të tillë që i intereson me pasë deponi ilegale në Obiliq, sepse kemi takue deponi ilegale çdokund. Mirëpo, në parkingun e sallës “Adem Jashari” me pasë deponi ilegale për mua ka qenë shokuese.

Fitore Hashani – Ne bashkë jemi kundër deponive ilegale dhe për atë e ke në Komunë: Kryetar sado që dukeni cinik kisha kërku pak më shumë seriozitet, sepse jemi për vite me radhë si një prej Komunave më të pastërta në nivel vendi. Për atë kemi marrë fonde dhe donacione. Ne nuk jemi në fushatë dhe ju kisha kërku këtyre asambleistëve të jenë pak më serioz, kryesues je për unifikim dhe për qetësi në sallë. Ju lutem të formosh kushte për seanca sepse është diçka që shihet dhe ju sado që ta mbani i keni nëpër dokumentet zyrtare këto çështje. Ju lutem merreni fjalën sepse nuk jeni në fushatë, zonjë, dhe nëse nuk e dini si duhet të silleni në Kuvend, kryesues kërkoj mirëkuptim. Unë kërkoja në bazë ligjore mos i vëni në lajthitje zyrtarët sepse nuk është në rregullë. Kryetar të lutem vetëm përgjegju në pyetjet që ti drejtoj, ato tjerat i flasim në fushatë.

Kryetari – Jo në fushatë jo, këtu kemi me i folë për 4 vjet.

Fitore Hashani – Unë po i flas të drejtat Kryetar, e jo diçka tjetër sepse pyetja ishte shumë e saktë të lutem plotësoje vendimin, dhe ballafaqou me situata dhe me ligje.

Kryetari – Gjatë tërë mandatit këtu kemi me folë.

Fitore Hashani – Prandaj po ju rikujtoj këtu do të më keni 4 vite gjithsesi dhe të pavërtetat gjithëherë do ti trajtojmë pavarësisht kushteve për punë që do të ofrohen këtu.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, për shkak të temës dhe për shkak se kam qenë drejtor i ambientit, unë mund të konstatoj se Komuna jonë është një ndër Komunitat më të ngarkuara sa i përket mbeturinave duke pasë parasysh edhe zonën e KEK-ut. Mirëpo, edhe këto kompanitë regjionale të cilat pa asnjë standard vijnë dhe hudhin mbeturina te na edhe pse është diskutue bukur gjatë për deponinë ilegale. Në rastet kur Kryetari e merrë me prioritet ambientin, mendoj se ai mund të bëjë edhe veprime të caktuara, me marrë vendime të caktuara të cilat e kanë një kohë deri në përmirësimin e gjendjes në terren. Unë e përgëzoj vendimin dhe përkundrazi kërkoj që të shtohen inspektorët. Edhe ne kemi punuar pa inspektorë të ambientit dhe drejtoresha e din saktë që nuk kemi pasë inspektorë të ambientit për shkak të normave, prandaj me rëndësi për qytetarët e tanë është të pastrohët ambienti dhe të largohen deponitë ilegale.

Fidan Ahmeti – Dua ta falënderoj Kryetarin për 2 kërkesat në seancën e kaluar që i kemi bërë njëerën prej tyre veç e realizove për shoqatën e kërkim shpëtimit, por edhe tjetrën për transportin publik deshta me ditë deri ku ka shku puna.

Kryetari – Te çështja e transportit publik është në finalizim të projektit në përgjithësi, dhe sigurisht që në javën e parë të marsit do ta kemi të përfunduar subvencionimin e transportit publik. Ne po mendojmë dhe politika jonë është subvencionimi për kilometër edhe pse do të punoj personalisht si Kryetar që ta kemi flotën e Obiliqit në të ardhmen për transportin publik.

Bajram Hashani – Në mbledhjen e kaluar kam diskutuar pak rreth mbeturinave. Vërtetë, Kryetari na ka premtuar se është duke u rregullu, por më vjen keq po i drejtohem z.Labinot sepse është java e tretë nesër që në lagjen ku jam unë pikërisht me vëllezërit e mi, aty nuk kanë ardhë me i marrë mbeturinat. Ndoshta, po i grumbullojnë dikund tjetër, por java e tretë po i drejtohem z.Labinot dhe, seriozisht, nuk e di pse po ndodh kjo. Sa i përket nxemjes qëndrore në rregullë është se janë duke punuar, por një pjesë e qytetarëve janë duke më pyet, janë disa rrugica në lagjen tonë që është papërfundue dhe ka mbetë në fazën e dytë. Faleminderit te unë është përfunduar deri aty ku ka qenë vija dhe janë duke punuar, por ka shqetësime të banorëve për disa pjesë sepse po kanë frikë po thojnë don me shkojë në Milloshevë, e mos po na anashkalojnë.

Kryetari – E para te çështja e KRM “Pastrimi”. U në personalisht si Kryetari i Komunës, jam për tu shkëputur prej KRM “Pastrimi” për ti marrë aksionet tona dhe KRM “Pastrimi ,me udhëheqje prej Kuvendit Komunal këtu, prej Ekzekutivit. Ne nuk mundemi me qenë barrë e keqpërdorimeve të Prishtinës, Lipjanit, Podujevës, Drenasit, apo kujdo qoftë tjetër. Këta djem po punojnë ju e keni parë edhe me kamioneta, me traktorë po mundohemi me i bartë mbeturinat ndërsa nuk po arrijnë. Unë kam kërkuar nga Kryetarët e Komunave që ne me u shkëputë prej KRM “Pastrimi” dhe defenitivisht me i dhënë kahje kësaj pune. Përndryshe po ia kthejmë mbledhjen e mbeturinave NPL “Kastriotit” dhe po vazhdojmë mëtutje. Ndërsa te pyetja e dytë, i siguroj qytetarët se askush nuk do të mbetet pa sistemin e ngrohjes qëndrore dhe ka mundësi që disa lagje i kanë kaluar për arsye se e kanë llogaritë kur vjen faza e kolektorëve ata do të kyqen. Pra, ka mundësi që janë 5 shtëpi që një kolektor që e merrë një lagje tjetër të lidhen aty. Duhet me qenë të sigurtë se nuk ka as për Milloshevë, as për Mazgit pa u kyqë të gjithë qytetarët e Obiliqit.

Bajram Hashani – Kryetar nëse, e merrë atë vendim me u shkëput unë të përgëzoj prej tash sepse vërtetë është shumë e qëlluar ajo se 3 javë me të vërtetë është shumë dhe tash dilni të gjithë në atë pozitë.

Kryesuesi – Deshta vetëm edhe një shpjegim për znj. Fitore dhe të gjithë të tjerët se ne vazhdimisht kemi vepruar kështu edhe në legjislaturën e kaluar në lidhje me dokumentet që na kanë ardhë prej MAPL-së, për arsye se shumë herë vijnë një ditë përpara dhe nuk ka mundësi me i përfshi në pikat e rendit të ditës. Për këtë arsye kam kërkuar prej MAPL-së, e cila më ka thënë se duke qenë se janë dokumente që kërkojnë shqyrtim urgjent ato që vijnë para dërgimit të rendit të ditës, do ti përfshijmë direkt në rend dite. Për seancat e ardhshme do të jetë kështu ndërsa, ato që vijnë pas dërgimit të rendit të ditës në momentin që vijnë te ne do ua dërgojmë edhe juve. Ne nuk jemi të gjithëdijsëm dhe ka mundësi të bëjmë gabime, por gabime të qëllimshme nuk bëhen, kështu që do të mundohemi të kemi transparencë sa më të madhe.


Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Zyrtare e lartë për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Sami Ahmet





KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

IZVOD IZ ZAPISNIKA

